

VENDIM
Nr.228, datë 27.5.1992

PËR RUAJTJEN E MJEDISEVE URBANE NGA NDOTJET DHE DËMTIMET

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ruajtja e mjediseve urbane dhe e peizazhit natyror brenda, në periferi e ndërmjet qyteteve e qendrave të tjera të banuara, si në rrugët trotuarët, mjediset e përbashkëta në lagjet e banimit, mjediset e gjelbëruara, parqet periferike, parqet kombëtare, anash rrugëve kombëtare, qendrat e pushimit jashtë qyteteve, plazhet, varrezat e në mjedise të tjera të kësaj natyre nga ndotësit (e ngurtë, të lëngët e të gaztë) dhe dëmtimet e ndërtimet pa leje të subjekteve të ndryshme, industriale, ndërtimore, komunale bujqësore, sociale, ushtarake, mjete transporti etj. është e detyrueshme për të gjitha personat juridikë e fizikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Mbeturinat organike të qyteteve të depozitohen në kushte stacionare, kurse të gjitha ndotjet e ngurta, të lëngëta e të gazta të depozitohen larg mjedisit urban e peizazhit estetik natyror, kryesisht jashtë qyteteve e qendrave të tjera të banuara në vende definitive të miratuara nga komitetet ekzekutive të rretheve përkatëse, mbi bazën e studimit paraprak të problemit nga sektoret dhe institucionet studimore, laboratorike e projektuese që kanë rrethet, Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Industrisë, Burimeve Minerare dhe energjetike dhe Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve.

3. Personat juridikë a fizikë që krijojnë vend depozitime të ndotjeve të ngurta, të lëngëta e të gazta, detyrohen të marrin masat e nevojshme për dezinfektimin, dezaktivizimin ose përpunimin e materialeve ndotëse dhe kthimin e tyre në lëndë të dobishme a të padëmshme për mjedisit urban dhe pejsazhin natyror.

4. Për të kontrolluar dhe parandaluar ndotjet dhe dëmtimet në të gjitha mjediset urbane dhe në peizazhin natyror të shprehura në pikën 1 të këtij vendimi, në komitetet ekzekutive të rretheve a rajoneve të organizohet e të funksionojnë inspektorati i ruajtjes së mjedisit urban e peizazhit natyror, si organ kontrollues e parandalues i ndotjes së këtyre mjediseve, sipas lidhjes që i bashkëngjitet këtij vendimi. Me miratimin e kryetarit të komitetit ekzekutiv, në ndërmarrjet përkatëse caktohet një deri në dy inspektorë.

5. Shkelja e dispozitave të këtij vendimi, kur nuk formon vepër penale, dënohet si kundërvajtje administrative nga inspektorët e ruajtjes së mjedisit urban e të peizazhit natyror me gjobë nga 500-1000 lekë, me detyrimin për eliminimin e ndotjes brenda një afati të caktuar dhe zëvendësimin e dëmtimit të shkaktuar.

Përsëritja e kësaj kundërvajtje dënohet me 3--5-fishin e gjobës fillestare.

Kur shkelja përbën vepër penale, inspektorimi ruajtjes së mjedisit urban bën denoncimin për fillimin e ndjekjes penale.

Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të dënimit, të kryetari i komitetit ekzekutiv të rrethit a rajonit, akti i të cilit është i formës së prerë.

6. Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, të hartojë rregulloren përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi